



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 25.02.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 22.02.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **BERISHA COM SH.P.K**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “**Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve te ngritura pa leje ndërtimi-Ilegale dhe shërbime tjera**”, me Nr. të Prok: 632-20-1610-5-2-1, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet si** e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik **BERISHA COM SH.P.K** e dt. 22.02.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve te ngritura pa leje ndërtimi-Ilegale dhe shërbime tjera**”, me Nr. të Prok: 632-20-1610-5-2-1,, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK –së, të datës 16.02.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
- 2. Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë: 16.02.2021;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Arsyetim

Operatori Ekonomik **BERISHA COM SH.P.K**, me datë 22.02.2021, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “**Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve te ngritura pa leje ndërtimi-Ilegale dhe shërbime tjera**”, me Nr. të Prok: 632-20-1610-5-2-1,.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 25.02.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

- 1. Për pretendimin tuaj të parë:** ne LPP dhe RRUOPP nuk shkruan që cili prej anëtareve të grupit duhet të paraqitet në dosjen e tenderit kështu që kjo pike është e paqëndrueshme;
- 2. Për pretendimin tuaj të dytë:** deklarata edhe pse nuk përmbajnë titullin dhe nr. e prokurimit, deklaratat për të gjithë anëtarët e grupit janë plotësuar siç duhet andaj kjo konsiderohet një shkelje e vogël që nuk ndikon në rezultatin përfundimtar të projektit;
- 3. Pretendimi juaj i tretë:** se selia e OE COMPANY BEJTA COMERCE, në deklaratën për betim dhe në deklaratën e konzorciumit janë ndryshe është i qëndrueshëm, mirëpo sipas ARBK selia e OE është në Gjilan andaj mund të konsiderohet si shkelje e vogël që nuk ndikon në rezultatin përfundimtar të projektit pasi që ne vule është në rregull;
- 4. Për pretendimin tuaj të katërt:** Deklaratat tatimore i ka ofruar anëtari i konzorciumit gjegjësisht lideri i grupit BEJTA COMMERCE në vlerë prej mbi 2 mil euro e që e tejkalon vlerën e kërkuar në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë.
- 5. Për pretendimin tuaj të pestë:** licenca – nuk ka qene fare kërkesë e përzgjedhjes tek kërkesat e kapacitetit teknik e profesional andaj ky pretendim është i paqëndrueshëm;
- 6. Për pretendimin tuaj të gjashtë:** kontrata punëtorëve – janë kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar për dhënie dhe OE ka ofruar dëshmitë e kërkuara andaj kjo pike është e paqëndrueshëm;
- 7. Për pretendimin tuaj të shtatë:** OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar gjithsej 5 lug ngarkuese, rimorkio me targa 06-408-XB ka peshe 10 ton dhe jo siç është dhënë prej jush, ndërsa rimorkio me targa 06-165-AX dhe 06-178-XB janë ofruar rimorkio shtese andaj nuk janë marr për bazë meqenëse në dosje të tenderit dhe njoftim për kontratë është kërkuar vetëm 1 rimorkio

Tenderi juaj është eliminuar se ka pasur çmim më të lartë dhe për arsye se:

1. Sipas kontratës inxhinieri Xhavit Jasiqi, është pjese e personelit të Autoritetit Kontraktues dhe nuk mund të kërkohej informacion shtese për kontratë e për të cilën ju thoni se është gabim teknik pasi që nëse do ndryshohej atëherë i bie që është falsifikim. Po ashtu, i njëjti inxhinier ka dërguar e-mail me datë 07.08.2020 ku deklaroi se “*i punësuar me kontratë të rregullt në Komunën e Junikut. Se me përgjegjësi morale dhe penale DEKLAROJ se nuk kam asnjë marrëveshje me kompaninë në fjalë për projektin “Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve te ngritura pa leje ndërtimi-Ilegale dhe shërbime tjera” me nr. prok. 632-20-1610-521. Po ashtu deklaroj se ndonjë kontratë eventuale për këtë projekt nuk është e nënshkruar nga unë.*”;
2. Sa i përket pajisjes Autovinç – është ofruar peshe 14570kg e që është nën peshën e kërkuar prej “mbi 15t”

3. Sa i përket pajisjes buldozher -- është ofruar marrëveshja mirëpo ne te nuk është dhëne pesha, pas kërimit ne internet është pare qe pajisja ka peshe siç është kërkuar mirëpo nuk është kërkuar sqarim shtese pasi qe jeni eliminuar edhe për dy pika tjera ankimore.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**


Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës